



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-**

NJOFTIM PARAPRAK PËRQËNDRIMI

Mbi përqendrimin nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Delhaize Albania Sh.p.k nga Balfin Sh.p.k

Në datën 7 Janar 2013, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar në bazë të “Memorandumit të mirëkuptimit”, të nënshkruar ndërmjet palëve (“Balfin Sh.p.k” në cilësinë e blerësit dhe “Delihaze Group S.A” në cilësinë e shitësit) më datë 20 Dhjetor 2012, me objekt përfundimin e kontrollit të shoqërisë Delhaize Albania Sh.p.k nga shoqëria Balfin Sh.p.k nëpërmjet transferimit të 100% të kuotave.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse në përqendrim është si vijon:

- Delhaize Albania Sh.p.k: ushtron veprimtarinë e saj në fushën e tregtimit me pakicë të produkteve ushqimore me anë të rrjetit të saj prej 18 dyqaneve Euromax në të gjithë Shqipërinë;
- Delihaze Group S.A: ushtron veprimtarinë si shitës ndërkombëtar me pakicë i produkteve ushqimore në 6 vende dhe në tre kontinente;
- Balfin Sh.p.k : ushtron veprimtarinë e saj në fushën e import-eksportit, shitjes me shumicë dhe pakicë të mallrave industrialë dhe ushqimorë, tregtimi i mallrave të ndryshëm, transport i mallrave, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b dhe 12, pika 1 të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al